

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Infeksionet në shtatzëni rrisin rrezikun e autizmit te fëmijët - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/infeksionet-ne-shtatzeni-rrisin-rrezikun-e-autizmit-te-femijet/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:46:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 09:17:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d4811da0ce9030513be0dee415ae0cdc9883d458cc97500ed0054dc25808b7a0
TEKSTI	d25ca34990d81defc8519ff1a2efa4c265f3117b30cf990c540f7d3360522b17
PAMJA	5e0a6abbd0b5a43f7ee06da5227c2edf0118b63ed0027d62b9ef62a9b11b4c81

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	df1da8bbfea9514164532d86cea31093758cf0782866a2449fe86be6431252f6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/df1da8bbfea9514164532d86cea31093758cf0782866a2449fe86be6431252f6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Infeksionet në shtatzëni rrisin rrezikun e autizmit te fëmijët

SHËNDET

Demo

Infeksionet në shtatzëni rrisin rrezikun e autizmit te fëmijët

SEPTEMBER 22, 2026



Fëmijët me infeksione që u transmetuan gjatë shtatzënisë kanë rreth tri herë më shumë gjasa të diagnostikohen me autizëm më vonë në jetë dhe më shumë se shtatë herë më shumë gjasa të diagnostikohen me aftësi të kufizuar krahasuar me fëmijët pa infektion. Këto janë gjetjet e një studimi të ri. Kjo sinjalizon se disa infeksione të transmetuara te fetusit gjatë shtatzënisë mund të kenë efekte afatgjata në zhvillimin e trurit, vërejtën autorët.

Infeksione të tilla, të njohura si TORCH, një grup infeksionesh që mund të transmetohen nga një grua shtatzënë te fetusit, përfshijnë sifilizin, rubeolën, toksoplazmozën, citomegalovirusin dhe herpesvirusin. Ndryshe nga shumë infeksione të zakonshme, këta patogjenë ndonjëherë mund të kalojnë placentën dhe të ndikojnë drejtpërdrejt te fetusit, duke rritur rrezikun e dështimit të shtatzënisë, lindjes së fëmijës së vdekur dhe komplikimeve gjatë shtatzënisë.

“Edhe pse këto infeksione kongjenitale janë të rralla, disa prej tyre mund të parandalohen, çka i bën ato të rëndësishme nga perspektiva e shëndetit publik,” tha Renee Gardner, kërkuese në Departamentin e Shëndetit Publik Global në Institutin Karolinska, e cila kontribuoi në studim. Studimi përfshiu 3.7 milionë njerëz të lindur në Suedi mes viteve 1987 dhe 2021. Nga këta, 975 ishin diagnostikuar me një infektion kongjenital TORCH. Kërkuesit i ndoqën pjesëmarrësit për deri në tri dekada për të hulumtuar nëse infeksionet ishin të lidhura me diagnoza të mëvonshme dhe me rezultatet arsimore. Përderisa këto infeksione përbëjnë një përqindje shumë të vogël të të gjitha rasteve të autizmit në popullatë, fëmijët e prekur kanë një rrezik të rritur si për autizëm, ashtu edhe për aftësi të kufizuar intelektuale. Një në pesë fëmijë të lindur me një infektion TORCH mund të zhvillojë më vonë autizëm, vërejtën autorët.

Përtej autizmit, lindja me infeksione të tilla u shoqërua me një rrezik më të lartë për aftësi të kufizuar intelektuale në të gjitha nivelet. Rreziku për aftësi të kufizuar intelektuale nga e rëndë deri në të thellë ishte deri në 30 herë më i lartë se te fëmijët pa infektion.

Edhe pa një diagnozë, infeksionet duket se ndikuan në rezultatet arsimore. Në studim, 420 persona u diagnostikuan me një infektion TORCH dhe patën rezultate të dobëta në shkollë pa u diagnostikuar me autizëm apo me ndonjë aftësi të kufizuar intelektuale.

Infeksionet TORCH variojnë në epidemiologji dhe përhapje. Më i përhapuri në nivel global është citomegalovirusi kongjenital (CMV), i cili prekur rreth një në çdo 150 të posalindur. Kjo barrë është dukshëm më e lartë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Si mund të ulen rreziket?

Sipas autorëve, studimi nënvizon rëndësinë e forcimit të strategjive parandaluese, veçanërisht në zonat me shkallë më të lartë infeksioni.

Studimi nxjerr në pah rëndësinë për shëndetin publik të zhvillimit, zbatimit dhe ruajtjes së strategjive të vaksinimit masiv për të parandaluar këto infeksione.

Postimet e reja

Arrestohet në Rusi një nga personat më të kërkuar...

SEPTEMBER 23, 2026

E ardhmja e Merz nën presion, 45% e...

SEPTEMBER 23, 2026

Ish-producenti i Hollywood-it Harvey...

SEPTEMBER 23, 2026

Presidentja në detyrë i ftoi në takim, familjet...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të “Top Fruits” të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjigantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, “Top Fruits”....

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznes të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Na ndiq

Autorët gjithashtu vërejtën se sistemet e tanishme — si ai në Suedi — mund të humbasin rastet asimptomatike sepse depistimi i të posalindurve për TORCH nuk është i zbatuar universalisht, dhe bënë thirrje për strategji më të mira për identifikimin e këtyre rasteve.

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët,
mundësi fitimi dhe sfida në punë,
çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3
shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.